

VENDIM
Nr.122, datë 14.3.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE DHE TË
MBIJETUARVE TË AKSIDENTIT RRUGOR, NË AKSIN KIR-DUKAGJIN, MË
12.3.2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, për prefektin e qarkut Shkodër, t’i shtohet fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, i cili të përdoret si ndihmë financiare për familjet e viktimave dhe të mbijetuarve të aksidentit rrugor, në aksin Kir-Dukagjin, më 12.3.2007.

2. Familjeve të viktimave t’u jepet shuma 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë për çdo viktimë.

3. Çdo të mbijetuari, për rehabilitimin shëndetësor, t’i jepet shuma 400 000 (katërqind mijë) lekë.

4. Fondi i përgjithshëm prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohet prefekti i qarkut Shkodër, që, në bazë të dokumenteve dhe procedurave ligjore, përfshirë dokumentin e identifikimit dhe dokumentet mjekësore, t’u shpërndajë përfaqësuesve të familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve shumat e përcaktuara në pikat 2 e 3 të vendimit, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefekti i qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha